



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo–Republic of Kosovo**  
**Kuvendi – Skupština – Assembly**

---

**Legjislatura IV**

**Sesioni pranveror**

**Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri**

Mbledhja nr. 116/2013

Prishtinë, më 30.07.2013, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala S–I

**P R O C E S V E R B A L**

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,  
TREGTI DHE INDUSTRI**

**Në mbledhje morën pjesë:** Zenun Pajaziti, kryetar, Teuta Sahatqija, Fikrim Damka, Sala Berisha–Shala, Shaip Muja, Lutfi Zharku, Ramiz Kelmendi, Myzejene Selmani dhe Etem Arifi.

**Munguan:** Hashim Deshishku dhe Visar Ymeri.

**Të ftuar:** Hazhi Arifi - anëtar i Bordit të AKP-së; Shkelzen Lluka - Drejtor menaxhues i AKP-së; Avni J. Jashari - Drejtor i financave dhe buxhetit i AKP-së.

**Pjesëmarrës të tjerë:** Ukë Gashi - ZPRK; Burim Ejupi – INDEP; Fehmi Pireva – Kuvendi i Kosovës; Qëndresa Mrasori – praktikante; Ilir Gashi – ZPRK; Blerta Bejtullahu – EUSK/EV; Arsim Rashiti -KosovaLive.

**Stafi Mbështetës i Komisionit:** Armend Ademaj dhe Muhamet Morina.

**Mbledhjen e kryesoi: zëvendëskryetarja e Komisionit, Teuta Sahatqija, më pas vazhdoi Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.**

**Në këtë mbledhje u propozua ky**

**Rend i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 24.07.2013;
3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit –AKP, për vitin 2012;
4. Të ndryshme.

*Kryesuesja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen sipas pikave të rendit të ditës.*

## **1. Miratimi i rendit të ditës**

**Myzejene Selmani** – Propozoi që rendi i ditës të plotësohet edhe me dy pika si: *Raporti i Komisionit Qeveritar për Privatizimin e 75 % të aksioneve PTK-së të futet në rend dite dhe t’i procedohet tutje Kuvendit, sepse është shtjerë debati dhe s’kemi më çka e mbajmë në Komision këtë Raport. Po ashtu ajo kërkoi që të futet në rend dite edhe shkresa e Kryesisë që të rishqyrtohen rekomandimet e Komisionit për Autoritetit të Konkurrencës të Kosovës-ës.*

*Pas diskutimeve deputetët me shumicë votash u pajtuan me propozimin e deputetes Myzejene Selmani.*

*Rendi i ditës u miratua duke shtuar edhe dy pika të lartpërmendura si vijon:*

*4. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit Qeveritar për privatizimin e 75% të aksioneve të PTK-së,*

*5. Shqyrtimi i Rekomandimeve në lidhje me funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës të Kosovës – AKK.*

## **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 24.07.2013**

*Procesverbali i mbledhjes së datës 24.07.2013 u miratua pa vërejtje.*

## **3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit –AKP, për vitin 2012**

**Kryesuesja** – Tha se për shqyrtimin e Raportit të AKP-së janë ftuar përfaqësuesit e AKP-së që ta prezantojnë raportin vjetor për vitin 2012, të cilën janë të pranishëm në këtë mbledhje.

**Myzejene Selmani** – Në drejtim të përfaqësuesve të AKP-së shtroi pyetjen se AKP a e ka edhe Raportin e Auditimit.

**Shaip Muja** – Pyeti pse nuk ka ardhur edhe dikush tjetër nga Bordi, po vetëm anëtarë i Bordit i cili është përfaqësues i sindikatave dhe i njëjti është i kontestuar nga vetë sindikatat.

**Kryesuesja Teuta Sahatqija** ia kaloi fjalën përfaqësuesve të AKP-së.

**Haxhi Arifi, anëtarë i Bordit të AKP-së** - Tha se zëvendëskryesuesi i Bordit është në gjendje shëndetësore jo të mirë, dy anëtarë të tjerë janë ndërkombëtarë, dhe një nga minoritetet. Ndërsa sa i përket kontestimit të tij ai tha se është i votuar nga vetë Kuvendi i Kosovës dhe ka mandat të plotë në Bordin e AKP-së. Ndërsa të raportojë më gjerësisht kërkoi që t’i jepet fjala drejtorit menaxhues z. Lluka.

**Shkelzen Lluka, drejtor menaxhues i AKP-së** – Tha se AKP vitin e kaluar ka mbetur pa anëtarë të Bordit, ndërsa ne, si menaxhment, jemi angazhuar ta mbajmë në funksion të plotë punën e Agjencisë. Në shkurt të këtij viti është plotësuar Bordi. Pas dorëheqjes së tre anëtarëve të Bordit ne, si Agjenci vazhdojmë punën brenda kompetencave në pajtim me ligjin. Bordi ka kuorum pasi që ka 5 anëtarë, por sfidë mbetet emërimi i anëtarëve në Bord, posaçërisht i përfaqësueses ndërkombëtare. Për momentin ai tha se është bllokuar shpërndarja e 20% përqindëshit dhe çfarëdo shpërndarje tjetër për shkak të mungesës së Bordit të pakompletuar. Procesi i privatizimit është në përfundim e sipër dhe ne, si Agjenci do të fokusohemi në dy segmente në likuidimin e ndërmarrjeve shoqërore dhe shqyrtimin e kërkesave të kreditorëve. Me ligjin e ri Autoriteti i likuidimit ia dërgon Bordit raportin për informim, ndërsa miratimin e bën

Oda e Veçantë e Gjykatës Supreme. Problemi kryesor me të cilin përballlet Agjencia është mos efikasiteti i Odës së Veçantë të Gjykatës Supreme, pasi që çdo çështje e procesit të likuidimit, privatizimit, aseteve të ndërmarrjeve shoqërore është e lidhur me Oden e Veçantë të Gjykatës Supreme. Sa i përket 20% përqindëshit për punëtorët deri tani janë bërë 130 milionë euro, prej tyre i janë shpërndarë punëtorëve 74 milionë. Shpërndarja e mjeteve të tjera janë peng i vendimeve të Odës së Veçantë të Gjykatës Supreme. Në Odën e Veçantë janë të hapura edhe 225 lista të punëtorëve, nëse këto aprovohen, Agjencia brenda një jave mund të shpërndajë pjesën tjetër. Gjykatësit ndërkombëtarë nuk e kanë njohur subjektivitetin e Agjencisë. Ne kemi ngritur çështjen në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës dhe vendimi i Gjykatës e njeh subjektivitetin e AKP-së në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Ligji për AKP-në ka 6 kërkesa ligjore për raportim dhe mbi bazën e tyre e kemi përgatitur raportin. Ne e dimë që ky nuk është raport gjithëpërfshirës, por ky raport bazohet në kërkesat ligjore. Çështja më e ndjeshme në punën e Agjencisë konsiderohet kompleksi Trepça. Ne kemi shpallur afatin për paraqitjen e kreditorëve. Ne, si Agjenci, në bazë të ligjit për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara shoqërore, respektivisht për Trepçën jemi të obliguar që të angazhojmë në ofrues profesional të shërbimeve që të bëjë planin për riorganizimin dhe rivitalizimin e Trepçës. Problem tjetër paraqet edhe kërkesa Kuvendit të Kosovës, e cila i Rekomandon Qeverisë të nxjerrë ligjin për Trepçën. Ne nuk guxojmë në asnjë mënyrë të mos përmbushim kërkesat ligjore që dalin nga ky ligj. Ekziston afati 60 ditor për paraqitjen e kërkesave të kreditorëve dhe nëpërmjet Odës së Veçantë mund të shtyhet edhe 30 ditë, që do të thotë që deri në qershorin e vitit të ardhshëm Agjencia duhet t'i paraqet planin e riorganizimit dhe rivitalizimit të Trepçës Odës së Veçantë të Gjykatës Supreme, e cila do ta thirrë takimin e parë të kreditorëve. Takimi i parë e cakton komitetin e kreditorëve dhe komiteti i kreditorëve duhet ta aprovojë këtë plan të riorganizimit dhe rivitalizimit, do të thotë ky organizim është për të kontrolluar Odën e veçantë të Gjykatës Supreme. Ne nuk duhet të paragjykojmë me ligjshmërinë e kërkesave të kreditorëve se janë të ligjshme, ose të paligjshme. Shifra të cilën e kërkojnë kreditorët është mbi 1 miliard euro.

*Kryesimin e mbledhjes së Komisionit e mori kryetari i Komisionit, Zenun Pajaziti.*

**Kryetari Zenun Pajaziti** – Falënderoi përfaqësuesit e AKP-së për prezantimin dhe ia dha fjalën deputetëve për të bërë pyetje.

**Myzejane Selmani** – Tha se Agjencia është pa Bord të kompletuar që nga vdekja e të ndjerit kryetarit të Bordit të AKP-së, Dino Asanaj. Edhe pse është kompletuar më pas, por menjëherë kanë dhënë dorëheqje tre anëtarë. Puna vazhdon në AKP, por vendimmarrja mungon. Ajo theksoi se AKP duhet të njihet nga Oda e Veçantë e Gjykatës Supreme. Ajo pyeti se çka u bë me Spin-off Speciale, çka po bëhet për Trepçën, takimet me kreditor, dhe u shpreh se nuk i beson këtyre kreditorëve. Po ashtu ajo pyeti se si është çështja e pronësisë së Trepçës, a është totale pronë e Kosovës edhe në veri edhe në jug? Çka doni të bëni me riorganizimin e Trepçës? Çka mundemi ne, si deputet, të ju ndihmojmë në rivitalizimin e Trepçës?

**Shkelzen Lluka (AKP)** – Theksoi se Agjencia edhe pa Bord ka qenë funksionale dhe ka punuar në pajtim me ligjin, por ka edhe vendime të Bordit që nuk kanë mund të kryhen për shkak të Bordit të pakompletuar. Spin-off speciale ato ndërmarrje që i kanë plotësuar kushtet janë liruar, dhe vlerësimet janë bazuar në raportin e auditimit. Ka edhe ndërmarrje që janë kthyer aksionet në AKP dhe përsëri kanë vazhduar procedurat e privatizimit. Problemi lidhur me Hotelin Grand rasti është në gjykatë, vendimi i shkallës së parë është në favor të Agjencisë, pala është ankuar në Gjykatën e Apelit dhe jemi në pritje të vendimit. Sa i përket pronësisë së Trepçës ai tha se të gjitha asetet e ndërmarrjeve shoqërore janë asete të Republikës së Kosovës. Trepça është një ndërmarrje e vetme me të cilën menaxhon AKP-ja. Në kohën e UNMIK-ut atëherë ishin vendosur dy menaxher, një në veri e një në jug, por tani jemi duke punuar që të jetë një menaxhment. Investimet në të kaluarën për Trepçën janë bërë gjatë masave të dhunshme. Gjatë

shqyrtimit të kërkesave të kreditorëve të Trepçës do t'i kemi në konsideratë sanksionet ndërkombëtare gjatë masave të dhunshme. Të gjitha transformimet kanë qenë fiktive. Së pari i kanë bashku me ndërmarrjet në Serbi, mandej i kanë transferuar aksionet.

**Myzejene Selmani** – Pyeti se Fondi i privatizimit a do të ketë mundësi të preket nga Serbia.

**Shkelzen Lluca (AKP)** – Tha se në asnjë mënyrë nuk mund të derdhen mjete jashtë buxhetit të Kosovës, secila kërkesë e kreditorëve do të shqyrtohet veç e veç.

**Kryetari Zenun Pajaziti** – Tha se është një raport i mirë dhe pyeti se si po shkon procesi i privatizimit, cilat sfida i keni, kur e parashihni se mund të përfundojë ky proces në Kosovë?

**Shaip Muja** – Tha se gjatë aktivitetit kur ka qenë Trepça në administrimin serb nga vitet 90(nëntëdhjetë) nuk e dëgjova nga plani ndërkombëtar juridik i së drejtës së pronës ku kontestohet veprimtaria e Serbisë në vendimmarrje karshi kreditorëve, kreditorët duhet me i pasur disa mekanizma garantues ndërkombëtar, nëse është gjend Serbia e Jugosllavia në atë kohë në gjendje lufte, a kanë pasur të drejtë të investojnë, dhe krijimi juridik i institucioneve të brendshme sa i privon ata nga ajo e drejtë që ata me u thirr si kreditor brenda. Ju si AKP a keni analiza juridike me stafin tuaj dhe ata ndërkombëtar që i keni aty për të drejtën e kreditorëve. Ai u shpreh se pas vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë mendoj që 1244 nuk duhet të funksionojë, BE-ja e ka pranuar vendimin e GJND-së, për këtë çështje as në këtë raport e as në raportet publike nuk sqarohet diçka.

**Shkelzen Lluca (AKP)** – Tha se ne, si Agjenci, jemi të thirrur t'i shqyrtojmë kërkesat e kreditorëve. Ne kemi dashtë me ditë sa kemi kreditorë, në mënyrë që riorganizimi i Trepçës të jetë sa më korrekt dhe të dimë vlerën e saj.

**Shaip Muja** – Tha se ju, si Agjenci duhet të bazoheni edhe në Rezolutën e Kuvendit të Kosovës për Trepçën.

**Shkelzen Lluca (AKP)** – Theksoi se sipas ligjit për AKP-në nuk kërkohet të përfshihet në raport Trepça si e veçantë. Ne, tha ai, e kemi një betejë ligjore me kreditorët në Odën e Veçantë të Gjykatës Supreme. Me shkresat që i kemi dërguar Kuvendit dhe Qeverisë dëshirojmë të marrim udhëzime nga Kuvendi se si të procedohet me Trepçën, a do të mbetet në pronësi të Kosovës tërësisht, pjesërisht, apo të privatizohet në tërësi, apo si të veprohet në këtë plan? Ne i marrim kërkesat e kreditorëve, i shikojmë a janë brenda afateve ligjore, mandej përballemi me kreditorët në Odën e Veçantë të Gjykatës Supreme. Ne mendojmë se procesi i privatizimit do të përfundojë në fillim të vitit të ardhshëm, pasi që nuk kanë mbetur asete atraktive thelbësore për t'u shitur. Ekzistojnë disa asete, të cilat janë thelbësore, por që janë të kontestueshme siç janë Pallati i Rinisë në Prishtinë, Objekti i Rilindjes, ndërsa Kosovatransat janë tërhequr nga përgjegjësia e AKP-së. Ai tha se për momentin jemi duke administruar me Pallatin e Rinisë dhe duhet të veprojmë në pajtim me ligjin. Po ashtu asete të kontestueshme janë Toka në Sharr e cila është Park Kombëtar, Brezovica. Së fundi kemi kërkuar nga Bordi që gradualisht ta zvogëlojmë stafin, në vazhdim do të përqendrohemi në procesin e likuidimit që pritet të zgjat 3, ose 4 vjet.

**Myzejene Selmani** pyeti se si do të rregullohet çështja e Pallatit të Rinisë.

**Shkelzen Lluca (AKP)** – Tha se çështja e Pallatit të Rinisë mendoj se do të rregullohet me Ligjin për Prishtinën, është çështje politike, e jo ligjore.

**Sala Berisha – Shala** – Ajo tha se AKP është njëri ndër institucionet më të komplikuar. Vitin e kaluar nuk është miratuar nga Kuvendi Raporti i AKP-së. Ju duke iu drejtuar AKP-së, sipas ligjit

raportoni për 6 pika kryesore, por ju jeni të themeluar nga Kuvendi dhe duhet t'i raportoni Kuvendit edhe për çështjet që nuk kërkohen të përfshihen me ligj. Ajo pyeti se sa ndërmarrje kanë mbetur pa u privatizuar? Sa do të zgjas privatizimi? Mendoj që raporti duhet të përfshijë një raport më të detajuar duke u bazuar në planifikimet për 2012 dhe përmbushjen e atij planifikimi. Në vazhdim pyeti se sa ndërmarrje janë privatizuar pa ofertues të nevojshëm sipas ligjit dhe pse janë privatizuar pa ofertues të nevojshëm? Sa ndërmarrje kanë dështuar të privatizohen? Pse kanë dështuar, sa valë parashihen të jenë në vitin 2013? Te Komisioni për shitjen e banesave në bashkëpronësi, sa është numri i përgjithshëm i banesave në pronësi të AKP-së? Pse janë refuzuar kërkesat për shitje? Cilat janë kategoritë në bazë të amortizimit të banesave? Sa objekte ka AKP të lëshuara me qira? Ajo nuk u pajtua me vlerësimin e AKP-së se Agjencia edhe pa Bord ka qenë plotësisht funksionale, sepse sipas kësaj po i bie që bordi pothuajse nuk është i nevojshëm, por ajo shtoi se edhe Bordi ka një pjesë të kompetencave dhe u përmend që shpërndarja e 20% përqindëshit të punëtorëve nuk është bërë për shkak të mungesës së Bordit. Në fund pyeti se çka mund të ju ndihmojmë ne, si Komision, në punën e AKP-së të zhblllokojmë situatat që paraqesin pengesa, edhe sa i përket mos efikasitetit të Odës së Veçantë të Gjykatës Supreme.

**Lutfi Zharku** – Kërkoj sqarim për Autoritetin e Likuidimit i cili ka autoritet edhe me vlerësuar edhe me gjykuar kërkesat, si ofrues i shërbimeve publike për ndërmarrjet, nga aspekti i konfliktit të interesit.

**Shaip Muja** – Lidhur me Sharr Prodhimin dhe Kullosat tha se pse nuk e privatizoni Sharr Prodhimin, ndërsa kullosat janë Park Nacional. Tha se janë privatizuar tokat bujqësore e nuk kemi ndonjë monitorim feedback për trajtimin e tokës, sepse ato toka bujqësore janë kthyer në toka ndërtimi, ose kanë mbetur djerrinë. Në shtator tha ai një grup i deputetëve të PDK-së do të kërkojë debat parlamentar lidhur me funksionimin e AKP-së nga fillimi deri tani për të gjitha sfidat për këtë çështje. Pse nuk ka një çmim tavan për shitjen e tokave, sepse janë shitur 25 hektarë pyll me 5 mijë euro, nuk besoj që mundet me pasur në Evropë, dhe kjo tha ai është një përgjegjësi e AKP-së që kanë lejuar që pronën shtetërore të minimizohet, nuk keni krijuar mekanizma monitoruese për me ndjek çështjen. Sot ka toka bujqësore që janë privatizuar nga ata që dhanë para e tokat rrinë djerrinë, e dihet që resurs për zhvillim në Kosovë është bujqësia.

**Shkelzen Lluca (AKP)** – Tha se me ligjin e ri për AKP-në janë të përcaktuara kërkesat për raportim, por nëse kërkohet të raportohet për çështje të tjera, ne jemi të gatshëm të raportojmë. Sa i përket vlerës së shitjes ai tha se është në diskrecion të Bordit se është vlerë e mjaftueshme apo jo? Ndërsa ne e shesim si tokë bujqësore pa kushte. Komunitat kanë kompetencë të transformojnë në tokë ndërtimi. Ne, si autoritet, nuk kemi kompetencë ligjore të përcjellim si i kryejnë aktivitet në bujqësi ose aktivitet e tjetër. Autoriteti i likuidimit bazohet në aneksin e Ligjit të AKP-së. Agjencia është autoritet i likuidimit. Me ligj është e përcaktuar që Agjencia të angazhojë ofrues të shërbimeve publike që së bashku me Agjencinë të themelojë autoritetin e likuidimit për secilën ndërmarrje veç e veç, por prapë se prapë të gjitha vendimet e Autoritetit të likuidimit mund të sfidohen në Odën e Veçantë të Gjykatës Supreme për likuidimin. Deri më tani janë shqyrtuar 20 mijë kërkesa të kreditorëve deri në fund të vitit presin të shqyrtohen edhe 20 mijë të kërkesa kreditorë.

**Lutfi Zharku** – Pyeti se Agjencia a e ka të drejtën e kontestimit të vendimit të Autoritetit të likuidimit?

**Shkelzen Lluca (AKP)** – Tha se në secilin autoritet të likuidimit është një anëtar i Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Vetë Autoriteti i likuidimit e ka dyshkallshmërinë e vlerësimit të vendimeve, mandej raporti vjen në Bordin e drejtorëve të AKP-së dhe shkon në Odën e Veçantë të Gjykatës Supreme.

**Lutfi Zharku** – Pyeti se çka ndodh kur AKP-ja është e pakënaqur me vendimin e Autoritetit të likuidimit?

**Shkelzen Lluca (AKP)** – Tha se të gjitha vendimet duhet të bihen në bazë të ligjit. Nëse një vendim i tillë nuk është marrë në bazë të ligjit secili përballlet me përgjegjësitë e veta. Në bazë të ligjit AKP-ja është autoritet i likuidimit, theksoi ai.

**Haxhi Arifi (AKP)** – Tha se mos kompletimi i bordit ka lënë një zbrazësi, tani edhe pse ekziston shumica nuk mund të ndajmë 20% përqindëshin. Brenga tjetër tha ai është mos kompletimi me gjyqtar në Odën e Veçantë të Gjykatës Supreme. Në këtë Gjykatë ka mos efikasitet, ndërrohen shpesh gjyqtarët ndërkombëtarë, nuk vazhdojnë me lëndë ku ka mbet gjyqtari paraprak. Nga 300 lëndë që janë nga 2009 deri më sot janë shqyrtuar dhe kanë përfunduar 5 lëndë nga kjo Gjykatë. Në këtë Gjykatë janë 20 gjyqtarë, 12 vendorë dhe 8 ndërkombëtarë. Në shpërndarjen e 20% përqindëshit bëhet edhe diskriminim, për punëtorët shqiptarë strikt përdoret rregullorja që është e AKP-së, kurse për të tjerët jo. Punëtorëve shqiptarë nuk u lejohet nëse ata nuk i plotësojnë të gjitha kushtet sipas rregullores, kurse të tjerëve po, thonë se s'kanë pasur siguri edhe pse i japim mandat një vit apo dy, me u kthye në vendin e punës, bile edhe me telefon me u lajmëruar ata kalojnë nëpër instanca jo të AKP-së, por diku tjetër.

**Kryetari** – Falënderoi përfaqësuesit e AKP-së për prezantimin e raportit dhe tha se jemi të vetëdijshëm për mungesën me anëtarë të Bordit dhe vështirësitë tjera. Ne, si Komision, do të provojmë që sa ma afër ta fusim në agjendë trajtimin e punës së AKP-së, qoftë një aktivitet monitorimi ose do të kërkojmë takime edhe me Odën e Veçantë. Ju e dini që ne kemi pasur procedura të përsheptuara për ta nxjerrë ligjin e ri, edhe për funksionimin e Dhomës Veçantë edhe për Ligjin për AKP-në, defektet që janë në funksionim të Bordit. Ne, si Komision, i kemi adresuar me kohë, kemi kërkuar plotësimin e Bordit, do të kërkojmë të futet një rekomandim që të plotësohet sa më shpejt Bordi.

*Pas debatit Komisioni unanimisht nxori këtë*

*Përfundim*

*Miratohet Raporti vjetor i punës së Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2012.*

*Kuvendit ia paraqiti këtë*

*Rekomandim*

- 1. Të miratohet Raporti vjetor i punës së Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2012.*
- 2. Arsyetimin e Raportit me rekomandime e paraqet kryetari i Komisionit, Zenun Pajaziti.*

#### **4. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit Qeveritar për privatizimin e 75% të aksioneve të PTK-së**

**Kryetari** – Tha se ne i kemi bërë disa aktivitete në lidhje me këtë Raport ku e kemi trajtuar në disa mbledhje dhe e kemi mbajtur një dëgjim publik. Po ashtu ju kemi drejtuar edhe Kryesisë që të procedojë për seancë, por Kryesia e ka kthye mbas dhe ka kërkuar të nxirret Rekomandimi i Komisionit dhe pastaj të procedohet për seancë. Në fund kërkoj që nëse dikush e merr fjalën dhe të votohet.

*Pas debatit Komisioni me 4 vota Për, 2 Kundër dhe 1 Abstenim nxori këtë*

## *Përfundim*

*Miratohet Raporti i Komisionit Qeveritar për privatizimin e 75% të aksioneve të PTK-së.*

*Kuvendit ia paraqiti këtë*

## *Rekomandim*

- 1. Të miratohet Raporti i Komisionit Qeveritar për privatizimin e 75% të aksioneve të PTK-së.*
- 2. Arsytimin e Raportit me rekomandime e paraqet kryetari i Komisionit, Zenun Pajaziti.*

## **5. Shqyrtimi i Rekomandimeve në lidhje me funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës të Kosovës - AKK**

**Kryetari** – Tha në javën e kaluar ju kemi drejtuar Kryesisë së Kuvendit më një “Kërkesë” që të kërkoj nga Qeveria që më urgjencë të procedojë propozimet për anëtarë të Komisionit të Konkurrencës dhe, Autoritetit të Konkurrencës të Kosovës më 5 Rekomandime që të funksionalizohet ai Autoritet. Por kemi tani një Përfundim të Kryesisë së Kuvendit që kërkohet të rishqyrtohen këto 5 Rekomandime.

**Lutfi Zharku** – Tha së në parim në nuk e kemi të qartë se çka kemi për të rishqyrtuar, se a duhet të gjitha Rekomandimet me i rishqyrtuar, ose cilën. Pastaj ai tha se Komisioni këto Rekomandime i ka nxjerrë në harmoni më Ligjin dhe Statutin e AKK-së, dhe kërkoj që të mos ndryshohen sepse është e panevojshme ndryshimi i tyre.

**Myzejene Selmani** – Tha se në Kryesi është diskutuar vetëm Rekomandimi i 3-të dhe është kërkuar të ndryshohet ajo pika ku ka të bëjë më administratën.

**Kryetari** – Tha se duke marrë parasysh këtë situatë duhet t’i drejtohem Sekretarit të Kuvendit që të na njoftojë më gjerësisht dhe të bëjë një këshillë juridike në lidhje më këtë çështje. Ndërsa, nga AKK të kërkohet që t’i zbatojnë Rekomandimet e tjera dhe të punohet në bazë të ligjit.

*Pas debatit Komisioni nxori këtë*

## *Konkluzion*

*Të kërkohet nga Sekretari i Kuvendit dhe Drejtoria e Përgjithshme Ligjore të sqarojë në detaje kërkesën e Kryesisë në lidhje më Rekomandimin Nr. 3, si dhe të japë një Këshillë juridike në lidhje më këtë çështje.*

## **6. Të ndryshme Çështjet vijuese**

**Mbledhja përfundoi në orën 12:00.**

### **E përgatiti:**

**Njësia për Mbështetjen e Komisionit.**

**Kryetar i Komisionit,**

-----  
**Zenun Pajaziti**